RAPORT

Mbi zbatimin e rekomandimeve sipas Rezolutës së Kuvendit 2022 për Institutin e Statistikave

I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit,

Mbështetur në Vendimin e Kuvendit nr. 49/2017, datë 20.4.2017 "Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj", lutemi gjeni në vijim informacionin mbi progresin e deritanishëm në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2022":

Rekomandimi 1

Të përmirësojë rolin e institucionit si koordinator i statistikave kombëtare dhe të ndërmarrë masa konkrete me qëllim zgjerimin e Sistemit Kombëtar Statistikor me institucione të tjera publike që prodhojnë statistika zyrtare.

Statusi: Në proces

Gjatë vitit 2022, Instituti i Statistikave (INSTAT) ka vijuar punën për përmirësimin e rolit të institucionit si koordinator i Sistemit Kombëtar Statitiskor. Rol të veçantë gjatë kësaj periudhe ka patur procesi i integrimit në Bashkimin Evropian. Konferenca ndërqeveritare ndërmjet Bashkimit Evropian (BE) dhe Shqipërisë, zhvilluar në 19 Korrik 2022, shënoi fillimin e një periudhe të re dhe vendimtare të procesit të integrimit të Shqipërisë në BE. Në këtë kuadër, INSTAT si koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor është udhëheqës i Kapitulit 18 "Statistikat", kapitull i cili është pjesë e pesë kapitujve të Cluster-it të parë.

Në vijimit të procesit të integrimit, në dt. 16 Shtator, në Luksemburg, u zhvillua takimi shpjegues për Kapitullin 18 "Statistikat", mbi risitë e akteve komunitare (acquis communautaire) dhe përafrimit të tyre me legjislacionin vendas. Në kuadër të zhvillimit të këtij takimi, mbështetur edhe në acqui e Kapitullit 18, u identifikuan ministritë apo institucionet që mund të merrnin pjesë në takimin shpjegues, duke vijuar më tej me pjesëmarrjen në takimin bilateral. Takime pune u zhvilluan me agjencitë statistikore/institucionet, pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe anëtarë të GNPIE, për të diskutuar përmbajtjen në nivel të detajuar (artikulli/aneksi), të akteve komunitare të miratuara rishtazi nga KE (2019-2021), për të identifikuar pikat e dobëta dhe çështjet e mundshme për sqarim paraprak në Komisionin Evropian.

Takimi bilateral për Kapitullin 18 "Statistikat" u zhvillua në datat 16-17 Nëntor, në Luksemburg. Në këtë takim përvec përfaqësuesve të INSTAT, morën pjesë edhe përfaqësuesit e institucioneve, pjesë e sistemit Statistikor, si Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si edhe agjensi të tjera si AKBN, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Ekonomisë të cilat sigurojnë informacion për prodhimin statistikor zyrtar.

Duke synuar zgjerimin e sistemit kombëtar, në këtë takim është ftuar edhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), e cila synohet të përfshihet brenda sistemit, duke marrë parasysh se mbulon fushën e statistikave të bilancit të energjisë dhe plotëson të gjitha hallkat e procesit të prodhimit të statistikave të kësaj fushe.

Tashmë, AKBN e ka shprehur gadishmërinë për të qene pjesë e SKS-së dhe kanë filluar diskutimet ndërinstitucionale për ndërmarrjen e hapave të mëtejshme. Një input domethënës në këtë drejtim do të jetë Raporti i BE-së për Shqipërinë në kuadër të Kapitullit18 "Statistikat", i cili pritet t'i dorëzohet së shpejti palës shqiptare.

Rekomandimi 2

Të intensifikojë punën nëpërmjet reflektimit të përmirësimeve të mundshme të rezultuara nga gjetjet e Pilot Censit, konsolidimit të të gjitha aplikacioneve, manualeve, materialeve të trajnimit dhe materialeve të tjera mbështetëse, që do të bëjnë të mundur realizimin e Censit të Popullsisë dhe të Banesave brenda vitit 2022.

Statusi: Në proces

Gjatë vitit 2022, INSTAT ka vijuar punën për zbatimin e gjetjeve të Pilot Censit, në drejtim të përmirësimit të materialeve dhe infrastrukturës mbështetëse për zbatimin e censit në vitin 2023. Konkretisht, është përfunduar pyetsori i Censit në 6 module, në dy gjuhë, shqip dhe anglisht; materialet shoqëruese si Manualet e stafit të terrenit (Anketues, Kontrollor); Modulet e trajnimit të stafit të terrenit, Zyrave Rajonale dhe stafit të INSTAT; Draft plani tabelar i rezultateve të Cens është përgatitur dhe është në proces; Është përditësuar dhe testuar aplikacioni i mbledhjes së të dhënave, pas reflektimit të ndryshimeve të 4 testeve dhe Pilotit të organizuar në Tetor 2021; Është ndërtuar platforma e monitorimit të cilësisë së punës së stafit të terrenit; Është përgatitur draft raporti për menaxhimin e cilësisë së të dhënave të Cens; Është përditësuar dhe testuar aplikacioni i mbledhjes së të dhënave, pas reflektimit të ndryshimeve të 4 testeve dhe Pilotit; Është ndërtuar platforma e monitorimit të cilësisë së punës së stafit të terrenit; Është përfunduar përditësimi i hartave me informacionet më të fundit dhe janë përcaktuar zonat e Censigt, të cilat numërohen në 5220 zona; Është ngritur dhe testuar dashboard-i i monitorimit me tregues cilësisë për të gjitha nivelet e organizimit të numërimit në terren. Aktualisht po bëhen vlerësime të modifikimeve të mundshme në aplikacionet për Censin si dhe për përditësimin e ndryshimeve të mundshme të ndërtesave.

Rekomandimi 3

Të sigurojë mbështetje me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare të fushatës së informimit të publikut për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave, si aktiviteti më i madh që INSTAT-i parashikon të realizojë për periudhën në vijim, si dhe vazhdimin e takimeve me pushtetin vendor për një identifikim të saktë të mundësive dhe elementeve që do të mund të sigurohen apo vlerësimin e risqeve për rastet kur njësitë vendore nuk mund ta mbështesin Censin.

Statusi: Në proces

U vlerësua sigurimi për mbështetje bazuar në takime dhe kërkesa zyrtare me pushtetin vendor dhe institucioneve te tjera lidhur me mbështetjen logjistike si edhe me ambiente për Censin e Popullsisë dhe Banesave. Janë realizuar takime informuese pranë shkollave të ndryshme.

Ka vijuar puna në kuadër të përgatitjes së fushatës konceptuale të komunikimit për censin e popullsisë dhe banesave në përputhje me strategjinë e komunikimit. Puna është fokusuar në përgatitjen konceptuale të materialeve promovuese dhe vizuale për fushatën e komunikimit si dhe në rekrutimin e stafit në terren.

Duke qenë se data e censit është përcaktuar të jetë 18 Shtator 2023, rekomandimi do të zbatohet plotësisht gjatë këtij viti në drejtim të mbështetjes logjistike, fushatës së informimit dhe sigurimit të nevojshëm të burimeve financiare e njerëzore.

Rekomandimi 4

Të përmirësojë cilësinë e të dhënave të regjistrave administrativë që lidhen me statistikat bujqësore, si dhe të finalizojë procesin e hartimit te projektligjit të ri "Për Censin e Bujqësisë dhe fermave bujqësore" duke mundësuar përafrimin e standardeve të reja sipas rekomandimeve të Programit Botëror për Censet e Bujqësisë 2020.

Statusi: Në proces

INSTAT nëpërmjet një kërkesë zyrtare drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kërkoi aksesin në regjistrin e fermës të ngritur nga MBZHR. Kjo kërkesë pati përgjigje pozitive nga ana e Minitrisë dhe, gjatë vitit 2023, pritet të akesohen të dhënat e kërkuara për të vlerësuar cilësinë e tyre. Aksesi në këtë regjistër do të ndikojë drejtpërdrejt në përmiresimin e të dhënave administrative të lidhura me statistikat e integruara të fermës dhe gjithashtu do të shërbejë si objektiv primar për të përcaktuar bazën e zgjedhjes në shërbim të procesit të mbledhjes së të dhënave për Censin e ardhshëm të Bujqësisë, parashikuar të kryhet në vitin 2024.

Në këtë drejtim, në përputhje edhe me Planin Kombëtar për Integrim, INSTAT është duke përgatitur projektligjin e ri për Censin e Bujqësisë, i cili do të jetë në linjë me rregulloren e BE nr.1091/2018, për statistikat e integruara të fermës si dhe kërkesat e reja të rregullores IFS 2023. Projektligji parashikohet të dërgohet në qeveri brenda 6-mujorit të parë të këtij viti.

Rekomandimi 5

Të përafrojë treguesit statistikorë për migracionin e jashtëm dhe azilin me legjislacionin e BE-së, si dhe të nënshkruajë brenda vitit 2022 memorandumin e ri të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, pjesë e të cilit do të jetë dërgimi i të dhënave për shtetasit shqiptare me vendbanim jashtë vendit.

Statusi: Realizuar pjesërisht

Me datë 27.07.2022 është nënshkruar memorandumi i ri i bashkëpunimit ndërmjet INSTAT-it dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Përsa i takon të dhënave të migracionit, iformojmë se INSTAT-i që prej 2017 ka mbledhur, përpunuar, analizuar dhe shpërndarë të dhënat mbi të huajt me leje qëndrimi, të huajt e parregullt si dhe statistikat mbi azil kërkuesit në Shqipëri. Këto të dhëna bënë të mundur plotësimin e disa indikatorëve mbi azilkërkuesit të cilët kërkohen nga pyetësorët e Eurostatit dhe transmetohen në mënyrë periodike. Në kuadër të përafrimit të statistikave të lejeve të qëndrimit, të huajt e parregullt si dhe statistikave mbi azil kërkuesit, INSTAT-i ka hartuar formate tip për mbledhjen e tyre nga burimet administrative në përputhje me rregulloret dhe definicionet e Eurostatit, duke bërë të mundur rritjen e indikatorëve të prodhuar dhe cilësisë së tyre sipas standardeve ndërkombëtare. www.instat.gov.al/media/10292/azilkerkuesit-ne-shqiperi-2021.pd

Rekomandimi 6

Të përmirësojë më tej përputhshmërinë për sa i përket përafrimit me standardet ESA 2010 të burimit të të ardhurave kombëtare bruto (GNI), si dhe të fillojë hartimin e Inventarit të GNI në bazë të përshkrimit ekzistues të burimeve dhe metodave të përdorura për të.

Statusi: Në proces

Gjatë vitit 2022, INSTAT-i ka vijuar punën në drejtim të përmirësimit të nivelit të përputhshmërisë së llogarive kombëtare me standartet ESA 2010 si në drejtim të përmirësimit të metodologjisë duke realizuar vlerësime eksperimentale për treguesit e punësimit, komponentët e ekonomisë së pavrojtuar, vlerësimin eksperimental të sekuencës së plotë të llogarive sipas sektorëve institucional, përpilimin e tabelave plotësuese të tabelave burim, përdorime; përmirësimin e vlerësimit të llogarive rajonale dhe vlerësimin e treguesve të familjeve, formimit bruto të kapitalit fiks sipas rajoneve, etj. Llogaritë kombëtare janë përfshirë në 6 (gjashtë) projekte statistikore në kuadër të projektit IPA MB 2019 të cilat kanë në fokusin e tyre rritjen e nivelit të përputhshmërisë dhe përafrimin me kërkesat e ESA 2010.

Të gjitha përmirësimet metodologjike do të jenë pjesë e inventarit të treguesit të të ardhurave kombëtare bruto i cili përshkruan në menyrë të detajuar burimet e të dhënave dhe metodat e vlerësimit të treguesve të PBB – së.

Rekomandimi 7

Të intensifikojë marrëdhëniet me shërbimin postar për aktivitetin e mbledhjes së të dhënave në përputhje me rekomandimet Peer Review të Eurostatit.

Statusi: Në vazhdimësi

Si pasojë e proceseve të përditësimit të adresarit në nivel vendi, INSTAT-i është i detyruar të shtyjë në kohë procesin e realizimit të këtij rekomandimi. Për këtë është njoftuar edhe Eurostati. Nga ana tjetër, INSTAT-i vazhdon të mbajë kontakte dhe të zhvillojë takime me përfaqësuesit e postës shqiptare, duke synuar përdorimin e shërbimit postar si një alternativë efikase për mbledhjen e të dhënave për qëllime statistikore.

Rekomandimi 8

Të forcojë bashkëpunimin me botën akademike dhe median në prodhimin e statistikave zyrtare duke zhvilluar metodologji dhe trajnime specifike, si dhe të dedikojë një hapësirë të faqes zyrtare të internetit të INSTAT-it për komunikimin me botën akademike, studiuesit dhe median.

Statusi: Në proces

Gjatë vitit 2022, INSTAT-i ka rritur bashkëpunimin me botën akademike për zhvillimin e metodave të reja statistikore, produkteve dhe shërbimeve, duke organizuar konferenca, takime, leksione të hapura apo botime të përbashkëta. Një memorandum bashkëpunimi është nënshkruar me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, ndërkohë që po punohet për nënshkrimin e një memorandumi me Universitetin Politeknik dhe një tjetër me Universitetin "Aleksandër Xhuvani".

Gjatë muajit Shkurt 2022, INSTAT ka zhvilluar takime dhe leksione të hapura për pedagogët dhe studentët e Programeve Master të Fakultetit Ekonomik. Në muajin Prill 2022, INSTAT-i ka zhvilluar takime me përfaqësues të botës akademike. Në bashkëpunim me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë është organizuar aktiviteti "Dita e INSTAT-it" në ambientet e këtij universiteti. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të sillte statistikat zyrtare pranë publikut të gjerë dhe të informojë mbi rëndësinë e tyre në marrjen e vendimeve dhe monitorimin e politikave për zhvillimin e shoqërisë. Ky aktivitet ishte i hapur për të gjithë pedagogët dhe studentët e këtij universiteti që dëshirojnë të njihen më shumë dhe të japin kontributin e tyre në përmirësimin e sistemit statistikor në Shqipëri.

Gjatë muajve Mars - Maj 2022, në kuadër të fushatës së komunikimit për Censin e Popullsisë dhe Banesave, ka zhvilluar disa takime me nxënës dhe mësues të shkollave 9-vjeçare, në 10 bashki të përzgjedhura. Synimi është informimi i familjeve nëpërmjet nxënësve mbi procesin e Censit, rëndësinë e bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së popullsisë shqiptare në Cens. Për më shumë informacion mbi takimet e zhvilluara, gjenden në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të INSTAT, si më poshtë:

http://www.instat.gov.al/al/cens-2022/

http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/aktivitetet/promovimi-i-aktiviteteve-statistikore/dita-e-instat-n%C3%AB-universitetin-mesdhetar-t%C3%AB-shqip%C3%ABris%C3%AB/

https://www.facebook.com/institutistatistikave

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me botën akademike, si faktor i rëndësishëm që ndihmon në përmirësimin e standardeve të prodhimit e përdorimit të statistikave zyrtare në fushën kërkimore-shkencore, në drejtim të përcaktimit të hapave konkret për arritjen e këtij qëllimi, INSTAT-i ka vazhduar punën për publikimin e revistës shkencore "Kërkimi" dhe revistës informative "Infostat".